




Democracy for Development
Demokraci për zhvillim
Demokratija za razvoj

TË GJETURAT E MUAJIT GUSHT - LAJMET E NJË ANSHME DHE GJUHËS OFENDUESE

Gusht, 2023



PËRMBAJTJA

1	PËRMBLEDHJA	3
2	METODOLOGJIA	5
3	TË GJETURAT KRYESORE	6
4	SHEMBUJT NË GJUHËN SHQIPE	8
5	SHEMBUJT NË GJUHËN SERBE	11

MONITORIMI I MEDIAVE GJATË MUAJIT KORRIK DHE ÇRREGULLIMET E INFORMACIONIT

1 Koha e monitorimit

1-31 Gusht 2023.

2 Fushë veprimi

Çrregullimi i informacionit në internet dhe mediat sociale: Uebfaqe, portalet online të lajmeve, Facebook, Youtube dhe Instagram.

3 Mostra

Në gjuhën shqipe dhe serbe.

4 Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është monitorimi i çrregullimeve në mediat online në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe, rreth zhvillimeve/ngjarjeve që kanë ndodhur gjatë muajit korrik në Kosovë.

Ky raport është përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) në kuadër të projektit “Mbulueshmëria dhe kuptueshmëria e çrregullimit të informacionit në Kosovë”, që mbështetet nga NDI dhe USAID në Kosovë. Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e Institutit Demokraci për Zhvillim dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NDI Kosovo.

1. PËRMBLEDHJA

Gjatë muajit gusht 2023, Instituti D4D, ka bërë monitorimin e mediave online dhe rrjeteve sociale: Facebook, YouTube dhe Instagram në Kosovë. Gjatë kësaj periudhe janë analizuar 500 artikuj në mostrën në gjuhën shqipe dhe 500 në mostrën në gjuhën serbe.

Gjatë muajit gusht narrativa e cila ka mbizotëruar më shumë në mostrën e gjuhës serbe, e cila sipas artikujve të identifikuar si më poshtë ka qenë se: “Terroristët e Kurtit TMERROJNË SERBËT” dhe “Kurti ka plane për të nxjerrë 40 serb në rrugë...”. Kështu duke pasur aludime në shumë artikuj në gjuhën serbe që kanë shpërndarë dezinformata që Kryeministri Kurti ka plane për 'shtypjen' dhe 'terrorizimin' e minoritetit serb në Kosovë.

Ndërsa në mostrën në gjuhën shqipe dy temat që kanë dominuar, kanë qenë rreth zhvillimeve politike në Kosovë, siç është arrestimi i biznesmenit, Ridvan Muharremi i cilësuar si person i afërt me Kryeministrin Albin Kurti dhe gjuha e përdorur nga Hysni Klinaku, ushtrues i detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së. Ndërsa dy kategoritë që kanë dominuar në mostrën në gjuhën shqipe kanë qenë polarizimi politik dhe gjuha e urrejtjes.

Gjithashtu, në përgjithësi gjatë monitorimit të mediave dhe portale online në muajin gusht, nga ana e mediave është vërejtur hiperbolizimi dhe dramatizimi i titujve të artikujve të publikuara, me qëllim të rritjes së klikueshërisë (clickbait).




Fig. 1.1. Mbulueshmëria e artikujve në gjuhën shqipe

Dy ngjarjet që kanë dominuar me më së shumti artikuj me përmbajtje të çrregullimeve të informacionit në ambientin medial në Kosovë kanë qenë:

- Në kategorinë **Polarizimi politik** në mostrën në gjuhën shqipe, janë prodhuar 35,671 rreth kësaj teme, prej të cilave janë analizuar 250 prej tyre me shpërndarjen më të madhe, ku 30 artikuj me çrregullim të informacionit me shpërndarjen më të madhe janë përzgjedhur për analizë më të detajuar, shembujt e të cilave mund t'i gjeni si më poshtë.




Fig. 1.2. Mbuleshmëria e artikujve në gjuhën serbe

Në mostrën në gjuhën serbe, gjatë muajit gusht, mbizotëruan ngjarjet në lidhje me zhvillimet në veri pas protestave nëpër komunat serbe si rrjedhojë e zgjedhjeve. Si rrjedhojë, shumica e mediave dhe figurave publike profilizonin Kryeministrin e Kosovës si “terrorist” që po “terrorizonte” komunitetin serb në Kosovë. Në tjetër temë e përfolur ishte edhe dialogu Kosovë-Serbi, ku shumë prej figurave politike në Serbi fajsonin faktorin ndërkombëtar për njëanshmërinë dhe përkrahjen ndaj Kurtit. Sipas grafikut tregon një dominim të artikujve që i kanë dhënë rëndësi dialogut Kosovë-Serbi, në krahasim me temat e tjera.

- Dialogu Kosovë-Serbi, në mostrën në gjuhën serbe për këtë kategori janë prodhuar gjithsej 16.289 rreth kësaj teme, prej të cilave kemi analizuar 300 me shpërndarjen më të madhe dhe 23 artikujt me çrregullim të informacionit janë përzgjedhur për analizë më të detajuar, shembujt e të cilave mund t’i gjeni më poshtë.

- Zhvillimet në veri, në mostrën në gjuhën serbe, për këtë kategori janë prodhuar gjithsej 4.164 rreth kësaj teme, prej të cilave kemi analizuar 200 me shpërndarjen më të madhe, në pikat më të larta në grafik, ku janë përzgjedhur 4 prej tyre për analizë më të detajuar, shembujt e të cilave mund t’i gjeni më poshtë.

2. METODOLOGJIA

Qëllimi i Institutit D4D, është identifikimi dhe luftimi i lajmeve me çrregullim të informacionit, trend ky në rritje të përhapjes së lajmeve të pasakta, të paverifikuara, dhe forma të tjera që përbëjnë çrregullim të informacionit.

Instituti D4D, ka bërë monitorimin e mediave online dhe atyre sociale për të identifikuar lajmet/artikujt të cilat përmbajnë çrregullime të informacionit. Monitorimi është bërë përmes nje platforme monitoruese, duke klasifikuar artikujt në bazë të kategorive që janë përcaktuar. Mediat online të cilat janë monitoruar përmes platformes Pikasa kanë qenë mbi 100 media online vendore, të rajonit dhe ndërkombëtare, të selektuara në një platformë monitoruese. Monitorimi dhe analizimi i artikujve me çrregullim të informacionit është bërë paralelisht në dy mostra: në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Përzgjedhja e shembujve nga të dyja mostrat është bërë duke u bazuar në përmbajtjen e artikullit i cili ka shpërndarë gjuhë të urrejtjes, clickbait, gjuhë ofenduese, gjuhë kërcënuese, nxitëse, artikuj me titull tendencioz. Kategoritë në të cilat fokusohet raporti janë: polarizimi politik dhe gjuha e urrejtjes në mostrën në gjuhën shqipe, kurse në mostrën në gjuhën serbe dialogu Kosovë – Serbi dhe zhvillimet në Veri.

3. TË GJETURAT KRYESORE

- Gjatë periudhës monitoruese është parë një trend i shpërndarjes së artikujve në mostrën e gjuhës serbe të cilat kontribojnë në ndërtimin e narrativës që Kryeministri Albin Kurti ka plane për “terrorizim” dhe “dëbim” të komunitetit serb në Kosovë. Duke nxitur kështu edhe më shumë ndasi ndër-etnike në një mjedis veçse të tensionuar politik midis Kosovës dhe Serbisë.
- Instituti D4D ka identifikuar një rritje të raportimeve me përmbajtje të titujve sensacional apo ‘clickbait’ të përdorur nga portalet online në lidhje me ngjarjet politike që kanë ndodhur gjatë gjithë muajit gusht.
- Zyrtarët dhe politikanët kanë përdorur gjuhë ofenduese dhe të urrejtjes ndaj njëri tjetrit. Ky haset gati në çdo deklaratë dhe postim në rrjetet sociale nga figurat publike që më së shumti i përkasin skenës politike. Kjo gjuhë e përdorur nga zyrtarë publik mund të kontriboj në ndasi politike dhe nxit komente negative dhe ofenduese në mes të qytetarëve nëpër rrjete sociale.
- Gjatë monitorimit të lajmeve për këtë muaj një e gjetur tjetër ka dal se përmes artikujve të analizuar në rrjetet sociale, është vërejtur një numër i madh i komenteve me gjuhë të urrejtjes dhe gjuhë ofenduese si rrjedhojë e lajmeve të prodhuara me çrregullim të informacionit.

4. SHEMBUJ NË GJUHËN SHQIPE


Klinaku i OVL-UÇK: Më parë e vras Albin Kurtin sesa të iki nga Kosova

29.08.2023 23:26



Portali i lajmeve, Klan Kosova, ka publikuar deklaratën e Hysni Klinakut, ushtrues i detyrës së kryetarit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, me titull: “Klinaku i OVL-UÇK: Më parë e vras Albin Kurtin sesa të iki nga Kosova”. Këtë deklaratë Klinaku e ka bërë përmes një postimi në rrjetin e tij social Facebook. Gjuha e përdorur nga Klinaku është gjuhë kërcënuese dhe nxitëse ndaj kryeministrit Albin Kurti.

Kjo deklaratë e drejtuesit të Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së kontribon në polarizim të mëtejshëm politik. Në të njëjtin artikuj të shpërndarë në faqen zyrtare të Klan Kosovës në Facebook shihet një reagim nga komentues të ndryshëm me tone të ashpra ofenduese drejtuar z. Klinaku. Komentet janë të listuara më poshtë. Ky artikull ka arritur të marrë 1,508 ndërveprime, 394 pëlqime, 1,069 komente dhe 45 shpërndarje.



Portali i lajmeve Nacionale ka publikuar një artikull me titull: “Kurti godet brutalisht të gjithë pas arrestimit të ‘Ridit’, por s’ia qet goja fjalën “vaj”. Ky artikull përbën çrregullim të informacionit pasi që titulli sjellë konfuzion tek lexuesi, me përdorimin e fjalëve “godet brutalisht”, duke e bërë kështu artikull ‘clickbait’ dhe mund të cilësohet si përmbajtje çorientuese me qëllim të paraqitjes negative të një individi. Ky artikull ka arritur të marrë 330 ndërveprime, 188 pëlqime, 140 komente dhe 2 shpërndarje.

Kurti godet brutalisht të gjithë pas arrestimit të "Ridit", por s'ia qet goja fjalën "vaj"

TRILLIHEPARË nga NATIONALE



Krasniqi: Zyrtarë të lartë të Qeverisë brenda VV-së kanë lënë gra shtatzënë, kanë vjedhur donacione ...



Portali i lajmeve Gazeta Express ka publikuar një artikull me titull: “Krasniqi: Zyrtarë të lartë të Qeverisë brenda VV-së kanë lënë gra shtatzënë, kanë vjedhur donacione”. Ish-deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Florim Krasniqi, në një emision televiziv, ka thënë se: “zyrtarë të lartë të Qeverisë brenda VV-së kanë bërë gjëra të ulëta morale, lënë gra shtatzënë e kanë vjedhur kerre donacione”. Ish-deputeti përmes kësaj deklarate drejton akuza të rënda për keqperdorimi të detyrës zyrtare duke përdorur edhe gjuhë mizogjene.

Akuzat e ish-deputetit të VV-së janë të pabaza pasi që pas verifikimit që ka bërë D4D, brenda vitit 2023, nuk ka pas raportime të tilla, siç pretendon ish-deputeti, Krasniqi. Ky artikull ka pasur 292 ndërveprime, 114 pëlqime, 162 komente dhe 16 shpërndarje.

Portali i lajmeve Epilogu ka publikuar një artikull me titull: “Kimete Berisha: Kurti po sillet si krye-terroristi, po i shpërblen ushtarët e Millosheviçit”, Ky lajm është me çrregullim të informacionit, me përmbajtje të gjuhës ofenduese, pasi që publicistja, Kimete Berisha e ka cilësuar kryeministrin, Albin Kurti si krye-terrorist, pas me emërimin të Radoica Radomiroviq si zëvendësministër në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim. Ky artikull ka arritur të marrë 307 ndërveprime, 216 pëlqime, 72 komente dhe 19 shpërndarje.

Kimete Berisha: Kurti po sillet si krye-terroristi, po i shpërblen ushtarët e Millosheviçit

August 8, 2023

4 minutes read



6. SHEMBUJ NË GJUHËN SERBE

Novi Kurtijev ultimatum, za tri dana hoće da istera 40 Srba na ulicu

Kancelarija za KiM osudila je nove poteze privremenih institucija u Prištini, nakon ultimatumu tzv. Kosova upućenog Srbima.

IZVOR: B92 | UTORAK, 22.08.2023. | 13:03

Čitačja lista | Tisutaj | Podeli




Portali i lajmeve B92, ka publikuar artikullin me titull: “Ultimatumi i ri i Kurtit, për tre ditë kërkon të nxjerrë 40 serbë në rrugë”. Më poshtë brenda artikullit shkruan: “Zyra për Kosovë e Metohi dënoi lëvizjet e reja të institucioneve të përkohshme në Prishtinë, pas ultimatumit të të ashtuquajturës Kosova, drejtuar serbëve.” Ky lajm ka shpërndarë përmbajtje me çrregullim të informacionit dhe informata të rrejshme, duke thënë se Kryeministri Kurti do ti dëboj “40 serbë në rrugë” dhe se për ta ekziston një ultimatum prej tre ditësh.

Titulli lë hapsirë për të marrë fjalën “dëbohen” në kuptimin e parë të kësaj fjale. Ky artikull ka 139 ndërveprime gjithsej, 136 pëlqime, 1 koment dhe 2 shpërndarje.

Portali Pink.rs gjithashtu ka shkruar një artikull mbi situatën në veri me titull: “SA DO TË HESHTË KOMUNITETI NDËRKOMBËTAR?! Terroristët e Kurtit TMERROJNË SERBËT edhe një herë në Mitrovicë, në kohën kur nënat dhe fëmijët janë në rrugë (VIDEO)”. Ky titull përmban lajm të pavërtetë, pasi që pjesa e dytë e titullit thotë se “terroristët e Kurtit” “tmerrojnë serbët”, duke i'u referuar policisë së Kosovës. Ky titull nuk bazohet në ansjë informatë apo fakt që do të arsyetonte këtë lajm. Prandaj edhe lajmi cilësohet si i pa vërtetë.


Brenda artikullit është e publikuar një video e marrë nga “X” ku shihet policia e Kosovës duke bërë kontrollat në trafik, ndërsa një qytetar serb po xhironte duke shprehur shqetësimin se diçka mund të ndodhë, duke e hiperbolizuar situatën në rrjetet sociale. Artikulli ka arritur të marrë 168 ndërveprime, prej tyre 23 pëlqime, 1 koment, 143 shpërndarje.



POLITIKA
DO KADA ĆE MEĐUNARODNA ZAJEDNICA DA ĆUTI?! Kurtijevi teroristi opet ZASTRAŠIVALI SRBE u Kosovskoj Mitrovici, i to u vreme kada su majke i deca na ulicama (VIDEO)

Zapad podržava Kurtijev aparthejd i progon Srba

Naša zemlja mora da se suprotstavi albanskim secesionistima na sve načine i da vodi politiku zaštite našeg naroda



Portali Politika ka publikuar një artikull me titull: Perëndimi mbështet apartheidin e Kurtit dhe persekutimin e serbëve” ku më tej tregon opinionin e zëvendës kryetarit të partisë radikale serbe, Aleksandar Seselj, duke shtuar se: “Vendi ynë duhet të kundërshtojë në të gjitha mënyrat separatistët shqiptarë dhe të udhëheqë një politikë të mbrojtjes së popullit tonë”.

Ky lajm përmban informacion të rrejshëm pasi që Albin Kurti nuk ka ndërrmarë ndonjë iniciativë që jep indikacione të qëllimeve për bashkim me Shqipërinë apo për separatizëm në mes të komuniteteve etnike brenda Kosovë, përderisa nuk ka ndonjë fakt që do ta vërtetonte këtë supozim. Për më tepër, përmes kësaj deklarate po nxitet urrejtja ndër-etnike tek serbët si në Kosovë ashtu edhe në Serbi. Ky artikull ka grumbulluar gjithësej 356 ndërveprime, kur prej tyre janë 305 pëlqime, 9 komente dhe 42 shpërndarje.

Instituti Demokracia për Zhvillim (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve që po brengoseshin gjithnjë e më shumë që procesi i shtetndërtimit e kishte lënë anash demokracinë. Vizioni i D4D-së është të promovojë një qytetari aktive dhe të arsimuar, e cila merr pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdor arenën publike për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus për shpërndarjen e resurseve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që sjellin zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politikat specifike, promovon një qasje ndërsektoriale për zgjidhjen e problemeve dhe trajton rutinën institucionale të vendimmarrjes duke rekomanduar përmirësime në rritje dhe operon me efektivitet maksimal në mënyrë që të promovojë plotësisht stabilizimin e Kosovës dhe zhvillimin demokratik. Për më shumë informata rreth aktiviteteve të D4D-së, ju lutemi vizitoni faqen tonë elektronike: **www.d4d-ks.org**

Mbështetur nga:



Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

659.3(496.51)(047)

Të gjeturat e muajit gusht-lajmet e një anshme dhe gjuhës ofenduese :
gusht, 2023 / përgatitur nga Instituti Demokraci për Zhvillim. -
Prishtinë : Demokraci për zhvillim, 2023. - 12 f. : ilustr. ; 28 cm.

ISBN 978-9951-823-48-7

ISBN 978-9951-823-48-7

